



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:136008
Datë: 19.03.2024
Numri i dokumentit: 05470097

PAKR.nr.27/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Krime të Rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Vaton Durguti kryetar, Afërdita Bytyçi dhe Kadrije Goga Lubishtani anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Gresë Latifi, në çështjen penale ndaj të pandehurit A.R., për shkak të veprës penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK-së, duke vendosur në lidhje me ankesën e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, PP.I.nr.118/2019 të datës 05.01.2024, e paraqitur kundër aktgjyimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.199/2023, dt. 29.12.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur konform nenit 390 të KPPK, me datë 01.03.2024 morri këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.199/2023, i datës 29.12.2023 **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Mitrovicë - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin PKR.nr.199/2023, të dt. 29.12.2023, e ka shpallur fajtor të akuzuarit A.R. për shkak të veprës penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK-së, ashtu që të njëjtin e ka gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në periudhën prej dy (2) vjet nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi nuk do të kryej vepër tjetër penale.

Është obliguar i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën prej 20 (njëzetë) euro, paushallin gjyqësor në lartësi prej 20 (njëzet) euro dhe në emër të Fondit për Kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 50 (pesëdhjetë) euro në afatin prej 15 ditësh pasi që aktgjykimimi të merr formën e prerë.

Pala e dëmtuar - përfaqësuesi i Autoritetit Pyjor të Kosovës, A.D., për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest të rregullt civil.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka ushtruar:

Prokuroria Themelore në Mitrovicë për shkak të vendimit mbi sanksionin penal me propozim që Gjykata e Apelit të Kosovës duke pasur parasysh pretendimet ankimore të ndryshoj aktgjykimin e ankimuar sa i përket vendimit mbi dënim dhe ndaj të akuzuarit të shqiptoj dënim më të ashpër. Përgjigje në ankesën e Prokurorisë së shtetit ka parashtruar mbrojtësi i të pandehurit A.R. av. L.P., me propozim që të refuzohet si e pabazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, ndërsa të vërtetohet aktgjykimimi i shkallës së parë në tërësi.

Prokurori i Apelit në parashtrësën PPA/I.nr.42/2024, të dt.25.01.2024 ka propozuar që të aprovohet ankesa e Prokurorisë ashtu që të ndryshohet aktgjykimimi i ankimuar në atë mënyrë që të akuzuarit A.R. ti shqiptohet dënim më i rëndë ndërsa të refuzohet si e pabazuar përgjigja në ankesën e prokurorit e parashtruar nga mbrojtësi i të akuzuarit A.R. av.L.P.

Gjykata e Apelit, caktoi dhe e mbajti seancën e kolegjit në pajtim me dispozitën e nenit 390 të KPPK-se, në të cilën ishte prezent mbrojtësi i të akuzuarit A.R. av.L.P., ndërsa nuk ka prezantuar

askush nga Prokuroria e Apelit, si dhe nuk ka prezantuar i akuzuari A.R. edhe pse kanë qenë të njoftuar në mënyrë të rregullt për kohën dhe vendin e mbajtjes së seancës.

Gjykata e Apelit, e shqyrtoi aktgjykimin e ankimuar, detyrimisht në kuptim të dispozitës së nenit 394 par.1 të KPPK, vlerësoi pretendimet ankimore të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, së bashku me shkresat tjera të lëndës dhe pas vlerësimit të njëjtave, gjeti se: **ankesa është e pabazuar.**

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit të njëjtën e shqyrtoi sipas detyrës zyrtare edhe në këtë drejtim konform nenit 394 par.1 të KPPK-së, gjeti se i njëjti nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 të KPP, e as shkelje të tjera të cilat detyrimisht do të kushtëzonin anulimin e tij.

Po ashtu, me ankesë nuk kontestohet as gjendja faktike të cilën e ka vërtetuar gjykata e shkallës së parë, prandaj as në këtë drejtim çështja nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj gjykate meqenëse konform dispozitës së nenit 383 par.2 të KPP-së, nuk mund të kontestohet aktgjykimi i ankimuar përkitazi me këtë bazë ankimore ngase i akuzuari A.R. e ka pranuar fajësinë në shqyrtimin fillestar dhe gjykata e kishte aprovuar pranimin e fajësisë, andaj aktgjykimi i ankimuar u vlerësua vetëm në frymën e pretendimeve ankimore sa i përket vendimit për dënim.

Pretendimet ankimore

Në ankesë Prokuroria Themelore në Mitrovicë thekson se, Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar drejt ka vërtetuar gjendjen faktike si dhe drejt ka vepruar kur të akuzuarin e ka shpallur fajtor për veprën e kryer penale, mirëpo me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit ka nxjerr konkluzion të gabuar për arsye se dënimi i shqiptuar është i butë dhe jo adekuat në krahasim me veprën e kryer penale e posaçërisht pasojën konkrete dhe rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale. Tutje, shton se Gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes për llojin dhe lartësinë e dënimit ndaj të akuzuarit është dashur të ketë parasysh dhe vlerësoj drejt rrethanat e parapara me Kodin e procedurës penale, pasi siç shihet nga arsyetimi i aktgjykimit nuk janë marrë për bazë dhe vlerësuar drejt të gjitha rrethanat me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë të dënimit ndaj të akuzuarit. Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit ndaj të akuzuarit gjykata ka mbivlerësuar rrethanat lehtësuese duke mos u dhënë

rëndësinë e duhur rrethanave rënduese si: shkallës së përgjegjësisë penale të akuzuarit, kufijve të dashjes së tij, dëmin e shkaktuar të dëmtuarës Autoritetit Pyjor të Kosovës në shumë prej 6.272 euro, mosgatishmërinë për pagesën e dëmit të shkaktuar, faktin se këto vepra penale janë të shprehura, duke theksuar më tej se me aktgjykimin e ankimuar nuk do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimit që në të ardhmen të mos kryej vepra penale të kësaj natyre dhe të tjera, e njuhërit nuk do të ketë ndikim edhe ndaj personave tjerë që mos të kryejnë vepra penale, andaj ka propozuar që Gjykata e Apelit në Prishtinë, si gjykatë e shkallës së dytë, duke pasur parasysh pretendimet e paraqitura ankimore ta ndryshoj aktgjykimin e Gjykatës Themelore - Departamenti për Krime të Rënda në Mitrovicë, PKR.nr.199/2023 dt.29.12.2023 sa i përket vendimit mbi dënim dhe ndaj të akuzuarit të shqiptoj dënim më të ashpër.

Gjetjet e Gjykatës së Apelit

Duke shqyrtuar aktgjykimin e ankimuar përkitazi me vendimin mbi dënimin, Gjykata e Apelit, konstaton se pretendimet e prokurorisë për një dënim më të ashpër ndaj të akuzuarit nuk janë të bazuara.

Nga arsyetimi i aktgjykimit të ankimuar rrjedh që Gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të dënimit i ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësisë së dënimit në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, ku si rrethanë lehtësuese vlerësoi pranimin e fajësisë nga i akuzuari, shprehjen e keqardhjes se i akuzuari është penduar për veprën të cilën e ka kryer, bashkëpunimin e të akuzuarit në të gjitha fazat e procedurës penale, pastaj faktin se i njëjti është familjar, i martuar, baba i tre fëmijëve, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata gjeti faktin se i pandehuri veprën penale e ka kryer me dashje, shkallën e përgjegjësisë penale, përgjegjësinë dhe përgjegjshmërinë e plotë, andaj, Gjykata të akuzuarit i shqiptoi dënim të kushtëzuar si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar duke vlerësuar se dënimi i shqiptuar është në përputhshmëri me shkallën e përgjegjësisë dhe të rrezikshmërisë shoqërore për veprën penale me të cilën akuzohet i pandehuri dhe se ka vlerësuar se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 38 të KPRK-së, se i pandehuri në të ardhmen do të përmbahet nga veprimet e paligjshme dhe do të bëjë rehabilitimin e tij, pasi që njëra nga qëllimet e dënimit është të parandaloj kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, në parandalimin e personave të tjerë në kryerjen e veprave penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Një vlerësim të këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit e pranon edhe kjo gjykatë, ngase gjykata e shkallës së parë mënyrë të plotë i ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa rrethanat e pretenduara në ankesën e Prokurorisë se ndaj të akuzuarit gjykata ka mbivlerësuar rrethanat lehtësuese duke mos u dhënë rëndësinë e duhur rrethanave rënduese, janë pretendime të pa bazuara pasi që të gjitha këto rrethana veçse kanë qenë objekt vlerësimi i gjykatës së shkallës së parë dhe si rezultat i këtyre rrethanave të akuzuarit i është shqiptuar dënim alternativ (dënim me kusht). Në anë tjetër prokuroria në ankesë nuk potencon ndonjë rrethanë të re apo rrethanë të cilën gjykata gjatë shqiptimit të dënimit nuk e mori parasysh për të vlerësuar gjatë matjes së llojit dhe lartësisë së dënimi, prandaj rrethanat e përmendura si në ankesë nuk justifikojnë një dënim tjetër nga ai të cilën i ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar, andaj të gjitha këto rrethana edhe sipas bindjes të kolegjit penal të kësaj gjykate japin bazë të mjaftueshme që arsyetojnë shqiptimin e dënimit nga gjykata e shkallës së parë si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, pasi që edhe më këtë dënim do të mund të parandalohet i akuzuari nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, si dhe do të parandalohen personat tjetër nga kryerja e veprave penale.

Gjykata e Apelit rikujton se, kufijte e shqyrtimit të ankesës konform nenit 394 të KPP-së, drejtojnë në shqyrtimin e aktgjykimin në pjesën për të cilën është ushtruar ankesë me propozimet e paraqitura andaj, në këtë drejtim marrë parasysh se propozimi ishte që ti shqiptohej një dënim më i ashpër, pra jo sanksion tjetër penal nga ai si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar rrjedh se është propozuar dënimi më i lartë i dënimit të shqiptuar, pra dënimi alternativ-me kusht, ashtu që në rrethanat e tilla kjo gjykatë ka refuzuar pretendimet ankimore si të pabazuara pasi që Prokuroria Themelore në Mitrovicë nuk ka potencuar ndonjë rrethanë të re të cilën gjykata e shkallës së parë nuk pati parasysh për të vlerësuar ndërsa në anën tjetër nga pretendimet në ankesë, si është theksuar më lartë, ato janë vlerësuar nga gjykata e shkallës së parë e për të cilat edhe kjo gjykatë është pajtuar me përfundimet përkitazi me këto rrethana për shqiptimin e lartësisë së dënimit.

Gjykata e Apelit, konstaton se në këtë çështje penale gjykata e shkallës së parë nuk e ka gjykuar plotësisht substancën e akuzës, duke aprovuar pranimin e fajësisë së të akuzuarit për veprimet dhe pasojat-dëmin e shkaktuar të dëmtuarës APK-ën, ashtu si i janë vënë në barë me aktakuzë dhe i akuzuari pranoi këtë akuzë, ndërsa gjykata të dëmtuarën e ka udhëzuar në kontest civilo-juridik, për dëmin e pranuar nga i akuzuari, e që në fakt është dashur që të akuzuarin ta obligoj që të dëmtuarës ti kompensoj dëmin e shkaktuar, si element i veprës penale për të cilën e ka

shpallur fajtor gjykata e shkallë së parë. Në rrethanat e tilla duke qenë se gjykata e shkallës së dytë kufizohet në kufijtë e shqyrtimit të ankesës konform nenit 394 të KPP-së, që drejtojnë në shqyrtimin e aktgjyqimit në pjesën për të cilën është ushtruar ankesë me propozimet e paraqitura, e që në këtë rast nuk pati pretendim ankimor në këtë drejtim, gjykata në rastin e këtillë nuk ka mund të veproj në drejtim të ndryshimit të aktgjyqimit të ankimuar.

Nga sa u tha më lartë, e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA
PAKR.nr.27/2024 më datë 01.03.2024

Bashkëpunëtore profesionale

Anëtarët e kolegjit

Kryetari i kolegjit

Gresë Latifi

Vaton Durguti

Afërdita Bytyçi

Kadrije Goga Lubishtani